



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 7635 Prot.

Tiranë, më 15.10.2014

URDHËR

Nr. 409, datë 15.10.2014

PËR

“PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË FAZËN DYTË TË PRANIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË TË CIKLIT TË PARË, PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE, PROFESIONALE DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit nr.517, datë 01.08.2014, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2014 - 2015”, Vendimit nr.78, datë 08.02.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

URDHËROJ:

1. Kuotat e parealizuara, pas përfundimit të raundit të parë të regjistrimeve në IAL publike në programet e studimit me kohë të plotë, të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të rishpërndahen, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Agjencia Kombëtare e Provimeve bën renditjen e maturanëve kandidatë, sipas parimit meritë preferencë mbështetur në kuotat e rishpërndara, shpall rezultatet dhe përcjell listat e kandidatëve fitues Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, brenda datës 23 tetor 2014.
3. Regjistrimi në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara

të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2014-2015, sipas programeve përkatëse të studimit, i maturantëve kandidatë, që shpallen fitues nga rishpërndarja e kuotave të përealizuara, kryhet në përputhje me Udhëzimin nr. 41, dt. 14.10.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit për plotësimin e kuotave të përealizuara në raundin e dytë dhe regjistrimit të kandidatëve fitues në programet e studimit me kohë të plotë, të ciklit të parë të studimeve, programet e studimeve jouniversitare, profesionale, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014- 2015”.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore Rajonale dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

